



Ch. 4050/1 Prot

16.08.22



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT SHKODER

Nr. 505/1 prot.

Shkodër, më 11.08.2022

Lënda: Mbi Vendimin nr. 48, datë 27.07.2022 të Këshillit Bashkiak Vau Dejës

KËSHILLI BASHKIAK VAU DEJËS

Prefekti i Qarkut Shkodër, në zbatim të detyrave të tij funksionale të përcaktuara në ligjin nr. 107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, neni 8, shkronja “a”, të Urdhërit të Kryeministrit nr. 50, datë 12.04.2017 “Për miratimin e detyrave të administratës së Prefektit të Qarkut”, të Urdhërit të MB nr. 175, datë 09.07.2020 “Për miratimin e rregullores së brëndshme “Për organizimin dhe funksionimin e Institucionit të Prefektit të Qarkut”, si dhe aneksin I, “Rregullat për procedurat e verifikimit dhe kontrollin nga Prefekti i Qarkut”, të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, neni 41, neni 54, shkronja “dh”, neni 55 pika 3, neni 64, shkronja “c”, të ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 36, pika 8, të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën me Shqipërisë” i ndryshuar, të Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 23, datë. 30.07.2018 “Per procedurat standarte të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të NJQV”, të ndryshuar, të Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 28.02.2022 “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2023-2025”, pika 14, të shkresës së Këshillit të Bashkiak Vau Dejës nr. 4045 prot., datë 02.08.2022 “Dokumentacioni i mbledhjes së Këshillit Bashkiak Vau Dejës, datë 27.07.2022”, shqyrtoi *VKB Vau Dejës nr. 48, datë 27.07.2022 “Për miratimin e projektit të parë të PBA 2023-2025 të Bashkisë Vau Dejës”*, miratuar me 16 vota pro.

Prefekti ju autorizon të procedoni, sipas konstatimeve në vijim, pasi vihet re se ka luhatje ndërmjet nivelit të parashikuar dhe të realizuar të të ardhurave në krahasim me vitet e kaluara dhe me planifikimin për vitet e ardhshme, e cila nuk shoqërohet me analizën përkatëse, si dhe tabelat për planifikimin e fondeve të trashëguara nga viti i shkuar për vitin 2022, janë me vlerë 0. Bashkia me qëllim përdorimin më ekonomi, eficientë dhe efektivitet të burimeve financiare publike , duhet ti përmbahet parimit të nenit 5, shkronja “a”, të ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

PREFEKTI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VAU DEJËS
KËSHILLI BASHKIAK



VENDIM

Nr. 48, datë 27.07.2022


**Për miratimin e Projekt-dokumentit të parë të Programit Buxhetor Afatmesëm
2023-2025**

Këshilli Bashkiak Vau Dejës në mbledhjen e tij të datës 27.07.2022, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, mbështetur në nenin 9 pika 1.3, nenin 34, neni 41 pika 1 të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore“, të ndryshuar, nenin 37 të ligjit nr.68/2017 ”Për financat e vetëqeverisjes vendore“, ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar, udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 23 date 30.07.2018 “ Per procedurat standarte te pergatitjes se programit buxhetor afatmesem te NjQV”; Udhëzimit Nr. 8 datë 28.02.2022 “Për Pergaditjen e Programit Buxhetor Afatmesem Vendor 2023-2025; Vendim i Keshillit Bashkiak Nr. 73 dt. 23.12.2021 “Për miratimin e kalendarit të pergaditjes së programit Buxhetor Afatmesem 2023-2025 dhe Buxhetit vjetor 2023 të Bashkisë Vau Dejës”, Miratuar me shprehje ligjshmerie nga Prefekti i Qarkut Shkodër me shkresen Nr. 13/1 Prot. dt. 14.01.2022.

**KËSHILLI BASHKIAK
V E N D O S I:**

1. Të miratojë projekt-dokumentin e pare për programin buxhetor afatmesem për vitet 2023 - 2025, te Bashkisë Vau Dejës, si më poshtë:
 - a) Të miratojë fondet buxhetore, të parashikuara sipas programeve buxhetore për çdo njësi shpenzuese, për vitet 2023-2025, të ndara në korrente dhe kapitale; sipas tabelës 1, pjesë përbërëse e këtij vendimi.
 - b) Të miratojë tavanet për çdo program, për vitin 2023-2025 të programit buxhetor afatmesëm sipas tabelës D1 të FPT (Instrumentit të Planifikimit Financiar), pjesë përbërëse e këtij vendimi.
 - c) Të miratojë të ardhurat sipas përputhshmërisë me rregullat fiskale në fuqi dhe shpenzimet e buxhetit, sipas zërave kryesorë, për dy vitet e mëparshme buxhetore dhe tre vitet e ardhshme, sipas tabelës C1 të FPT, pjesë përbërëse e këtij vendimi.
 - d) Të miratojë numrin e punonjësve të Bashkisë Vau Dejës dhe institucioneve në varësi për vitin 2022, sipas tabelës 2” pjesë përbërëse e këtij vendimi.

- e) Të miratojë detajimin e shpenzimeve sipas klasifikimeve buxhetore për vitet 2023-2025 sipas "Tabelës 4" të FPT, pjesë përbërëse e këtij vendimi.
- f) Të miratojë listën e projekteve të investimeve publike, për çdo program, sipas tabelës "Tabelës 8" të FPT, pjesë përbërëse e këtij vendimi.



2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes publike (sipas përcaktimeve të nenit 55 pika 6 të ligjit nr 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore").

KRYETAR

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Ardian Çelepija



Mark Bisha

Miratuar me 17 vota

Vota Pro 16

Vota Kundër 1 (një)

Vota Abstenim —

Zbardhur me datë 02.08.2022.